



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:022415

Datë: 30.11.2020

Numri i dokumentit: 01307833

C.nr.235/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses R. M.-M. nga Gjilani, të cilën me autorizim e përfaqëson Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari i saj ligjor Arben Mehmeti nga Gjilani, me objekt kontesti: pagesa e shpërblimit jubilar dhe pagesa e shpenzimeve për ushqim, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datën 14 Tetor 2020, jashtë seancës gjyqësore, më datë 13 Nëntor 2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditëses R. M.-M. nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan dhe **OBLIGOHET** paditura që paditëses, t'ia paguaj, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune në vlerë të 75% të një page bazë, respektivisht shumë prej 315,75€ si dhe kompensimit të ushqimit ditor për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.31.01.2020, shumë e të hollave në lartësi prej 1,018.00€(për 509 ditë pune),respektivisht shumë e përgjithshme prej 1,333,75€, me kamatë ligjore 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (data 13.11.2020), si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 269€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërkënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja R.M.-M. nga Gjilani, në këtë gjykatë më datë 13.02.2020, përmes të autorizuarës të saj Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e saj dhe të obligohet e paditura që paditëses R.M.-M., në emër të shpërblimit jubilar për 26 vite përvojë pune pandërprerë t'ia paguaj në vlerë të 75% të një page bazë, respektivisht shumë e të hollave në lartësi prej 315,75€ dhe t'ia paguar në emër të ushqimit ditor shumë prej 2 eurove në ditë ashtu siq parashihet në Kontratën Koletive të Arsimit të Kosovës, prej datës 18.04.2017 deri më datën 31.01.2020 shumë prej 1018 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, krejt këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërkënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më dt.19.06.2020 ku e paditura të njëjtin aktvendim e ka pranuar, ndërsa përgjigjen në padi e ka ushtruar me datë 26.06.2020. Me aktvendimin për

përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për arsye se paditësi kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga MASHT(Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë) dhe SBASHK(Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8.4 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komuës së Gjilanit si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti i dt. 06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Tutje ka theksuar se kjo kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pagat jubilarre sipas Kontratës Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesa është 30 ditë nga koha e të drejtës për këtë kompensim ndërsa në rastin konkret kemi tejkalim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkese ndërsa nuk kemi ndonjë shkresë që paditësi në afat prej 30 ditëve ka të ketë kërkuar realizimin e kësaj të drejte.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 14.10.2020 është mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të paditurës pasi që nga fletëkthesa për dorëzim personal është konstatuar që e njëjta ftesën për seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt me dt.23.09.2020, por të njëjtës nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

E autorizuar e paditëses si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova materiale: Kontratë pune për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr.të protokollit 1200 e dt.01.09.2015; Lista e pagave e dt.01.11.2019 deri më dt.30.11.2019; Vërtetimi nga SHFMU “..” 01-03-20 e dt.07.02.2020 mbi përvojën e punës; Kërkesa e paditëses adresuar Komunës së Gjilanit me nr.të protokollit .. e dt.28.01.2020; Vërtetimi nga SHFMU “...” me nr. Të protokollit 25/2020, e dt. 28.01.2020, mbi përvojën e punës dhe ditët e punës.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:se paditësja R.M.-M. fillimisht ka punuar në SHFMU “...” në fshatin .. në vendin e punës arsimtare e mësimin lëndor-matematikë ndërsa që nga data 01.09.2015 ka filluar të punojë të SFMU “...” në Gjilan në të njëjtën pozitë ku edhe më tutje vazhdon të punoj dhe ka gjithësejt përvojë pune mbi 26 vite, fakt ky i vërtetuar nga Lista e pagave e dt.01.11.2019 deri më dt.30.11.2019 ku përvoja e punës të njëjtës i figuron 27 vite.

Nga kontratë pune për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr.të protokollit 1200 e dt.01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me të paditurin ka lidhur Kontratë pune për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjilan.

Lista e pagave e dt.01.11.2019 deri më dt.30.11.2019, gjykata vërtetoi faktin që paga bazë e të njëjtës është 421€.

Nga vërtetimi nga SHFMU “..” ... e dt.07.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se e njehta në këtë shkoll ka punaur që nga data 01.09.1995-31.08.2000 dhe ka 5 vite përvojë pune.

Kërkesa e paditëses adresuar Komunës së Gjilanit me nr.të protokollit 25.2020 e dt.28.01.2020 nga e cila gjykata vërtetoi faktin që fillimisht paditësja nga DKA i ka kërkuar kompensimin për përvojën e punës dhe ushqimin ditor.

Nga vërtetimi i datës 28.01.2020 i lëshuar nga Drejtori i SHFMU “..” në Gjilan gjykata vërtetoi faktin se e njejtat që nga data 17.04.2017 e deri më datën 31.01.2020 ka gjithësej 509 ditë pune.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt.18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë) konkretisht nenin 35 par. 7 dhe 8 të kësaj Kontrate , ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimroe në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit duke e obliguar të paditurën që paditëses R. M. nga Gjilani, t’ia paguaj, në emër të shpërblimit jubilar për 26 vite përvojë punë në vlerë të një page bazë, respektivisht shumë e të hollave në lartësi prej 315,75 si dhe në emër të kompensimit të ushqimit ditor për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datën 31.01.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1, 018.00 euro (për 509 ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,333,75€.

Ndërsa sa i përket shumave të aprovuara gjykata u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitare të datës 18.04.2017, ku në nenin 35.7 ku është përcaktuar që *“Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë përnjë ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore.* Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restauranit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve, si dhe nenin 35 par. 8 ku shprehimisht është përcaktuar se *“ Punëtorët(anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: kurse pika 8.3 parasheh “Për 20 vjet të përvojë së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të 75% të një page bazë,ndërsa neni 8.5 shprehimisht ka paracaktuar se “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënsi kur i punësuar i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, andaj edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.*

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzime të procedurës gjyqësore , duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së pasi që e paditura në rastin konkret ka humbur procesin dhe për këtë arsye vendosi që paditësit t’ia paguaj shumën prej 269 €, dhe atë shumën prej 30€ për taksën për padi, shumën prej 104 për përpilimin e padisësi dhe shumën prej 135 € në emër të përfaqësimit për një seacën të mbajtur. Sa i përket shumave të lartcekura gjykata u bazuar në TA për avokat dhe në Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatë ka vendosur në mbështetje të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së.

Gjykata administroi edhe prova të tjera materiale, por të njëjtat nuk i arsyetoi, pasi që ishin pa ndikim në vendosjen e çështjes.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.235/20, më datën 13 Nëntor 2020**

**Gjyqtarja,
Mirvete Alidemi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.